



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 147/4 Prot.

Tiranë më, 20/04/2022

**VENDIM**

**Nr. 13, datë 20.04.2022**

**Për**

**“Transferimin e fondit prej 2.040.000 lekësh, i projektit “Atlasi etnografik i fshatit shqiptar sot” nga artikulli 602 në artikullin 231”**

Në mbështetje të shkresës me Nr. 18 Prot, datë 07.03.2022 “Kërkesë për një korrigjim dhe transferim nga zëri 602 në zërin 231 investime të fondit prej 2.040.000 lekë, dhënë nga AKKSHI për IAKSA-n, për projektin “Atlasi etnografik i fshatit shqiptar sot” me qëllim realizimin e blerjeve të pajisjeve logjistike parashikuar në projektin në fjalë”, ku sqarohet se në buxhetin e projektit “Atlasi etnografik i fshatit shqiptar sot” të mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe që zbatohet nga IAKSA, parashikohen: 1. Shpenzime që i përkasin zërin 602 ekspedita, honorare etj; 2. Blerje pajisjesh logjistike në shumën 2.040.000, vlerë e cila do të duhej të kishte kaluar në zërin 231, por gabimisht i gjithë fondi i parashikuar për këtë projekt kaloi në zërin 602. Duke qenë se fondi prej 2.040.000 nuk kaloi në zërin 231 u bë e pamundur blerja e pajisjeve logjistike të cilat janë të rëndësishme për projektin.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe bazuar në Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në mbledhjen e tij të radhës Bordi i Administrimit,

**VENDOSI**

1. Shuma prej 2.040.000 lekësh, dhënë nga AKKSHI për IAKSA-n, për projektin “Atlasi etnografik i fshatit shqiptar sot” në artikullin 602 të përdoret për nevojat e ASA-së.
2. Për llogari të projektit “Atlasi etnografik i fshatit shqiptar sot”, të përdoret fondi i njejtë, prej 2.040.000 lekësh nga buxheti i ASA-së artikulli 231.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i ASA-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**EMIS ÇERAVA**

